



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 10/9 Prot.

Tiranë, më 26.07.2016

**V E N D I M**

**Nr.94, datë.26.07.2016**

**Për verifikimin e zbatimit të vendimit nr. 59, datë 20.05.2016 “Mbi vlerësimin e ligjshmërisë së procedimit disiplinor për disa prej punonjësve të Bashkisë Tiranë (Njësia Administrative Farkë), proces i filluar me urdhrin e verifikimit nr.10/1 prot., dt.13.01.2016”.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Bashkia Tiranë me shkresën nr.15644/1, dt.17.06.2016, në lidhje me zbatimin e vendimit nr.59, dt.20.05.2016 “Mbi vlerësimin e ligjshmërisë së procedimit disiplinor për disa prej punonjësve të Bashkisë Tiranë (Njësia Administrative Farkë), proces i filluar me urdhrin e verifikimit nr.10/1 prot., dt.13.01.2016”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**Vërej se:**

Në zbatim të Urdhrit të Verifikimit nr.10/1, dt.13.01.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me disa parregullsi të konstatuara në procedurën e ndjekur në dhënien e masës disiplinore”vërejtje”, ndaj disa punonjësve të Njesisë Administrative Farkë, është kryer hetimi i plotë administrativ.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr.59, datë 20.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Mbi vlerësimin e ligjshmërisë së procedimit disiplinor për disa prej punonjësve të Bashkisë Tiranë (Njësia Administrative Farkë), proces i filluar me urdhrin e verifikimit nr.10/1 prot., dt.13.01.2016”, në të cilin është vendosur:

- 1.Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, të drejtojë procesin e revokimit të akteve administrative për dhënie mase disiplinore, të nxjerra nga Administratori i Njesisë

Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, si akte absolutisht të pavlefshme, sipas renditjes së mëposhtme:

- Akti nr.1183/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
  - Akti nr.1186/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
  - Akti nr.1187/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
  - Akti nr.1179/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
  - Akti nr.1185/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
  - Akti nr.1181/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
  - Akti nr.1182/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
  - Akti nr.1180/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
  - Akti nr.1176/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
  - Akti nr.1177/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”;
  - Akti nr.1178/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”.
2. Njësia përgjegjëse, të drejtojë realizimin e procesit të fshirjes së shënimeve të mundshme që janë bërë në dosjet personale të nëpunësve dhe në regjistrin e personelit, për masat e mësipërme disiplinore.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijani për këtë vendim.

Me kalimin e afatit procedural të parashikuar në pikën 3 të Vendimit nr.59, dt.20.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Bashkia Tiranë me shkresën nr.15644/1, dt.17.06.2016, të Kryetarit të Bashkisë ka njoftuar Komisionerin në lidhje me zbatimin e vendimit të mësipërm.

Nga verifikimi i këtij akti, rezultoi se:

- ✓ Në zbatim të pikës 1 dhe 2 të Vendimit nr. 59, datë 20.04.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë , ka revokuar aktet administrative për dhënie mase disiplinore, të nxjerra nga Administratori i Njesisë Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, si akte absolutisht të pavlefshme, si dhe ka fshirë shënimet që janë bërë në dosjet personale të nëpunësve dhe në regjistrin e personelit, për masat disiplinore sipas renditjes së mëposhtme:

- Akti nr.1183/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, është revokuar;
- Akti nr.1186/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, është revokuar;
- Akti nr.1187/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, është revokuar;
- Akti nr.1179/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, është revokuar;
- Akti nr.1185/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, është revokuar;
- Akti nr.1181/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” është revokuar;
- Akti nr.1182/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, është revokuar;
- Akti nr.1180/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, është revokuar;
- Akti nr.1176/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, është revokuar;
- Akti nr.1177/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësën \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, është revokuar;
- Akti nr.1178/1 prot., datë 31.12.2015, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, është revokuar.

Sa më sipër, konstatoj se, Vendimi nr.59, datë 20.05.2016 , “Mbi vlerësimin e ligjshmërisë së procedimit disiplinor për disa prej punonjësve të Bashkisë Tiranë (Njësia Administrative Farkë), proces i filluar me urdhrin e verifikimit nr.10/1 prot., dt.13.01.2016”, është zbatuar nga ana e subjektit, **Bashkia Tiranë**.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.59, dt.20.05.2016, në institucionin, Bashkia Tiranë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 59, datë 20.05.2016 , “Mbi vlerësimin e ligjshmërisë së procedimit disiplinor për disa prej punonjësve të Bashkisë Tiranë (Njësia Administrative Farkë), proces i filluar me urdhrin e verifikimit nr.10/1 prot., dt.13.01.2016”.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Tiranë dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**